



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E AELIT TË JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
ZËVENDËSKRYETARI**

Nr. 2514/1 Prot.

Tiranë, më 18.02.2026

URDHËR

Nr. 40, datë 18.02.2026

PËR

**MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PROCEDURËN E SINJALIZIMIT DHE
MBROJTJEN E SINJALIZUESVE” NË GJYKATËN E AELIT TË JURIDIKSIONIT TË
PËRGJITHSHËM**

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullores “Për procedurën e sinjalizimit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm” sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Për zbatimin e kësaj rregulloreje ngarkohen të gjithë nëpunësit e Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
3. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYETARE

ILIBA BEZATI



RREGULLORE

“PËR PROCEDURËN E SINJALIZIMIT DHE MBROJTJEN E SINJALIZUESVE”

Pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm

Neni 1 Baza Ligjore

Kjo rregullore përcakton rregullat për krijimin, organizimin dhe funksionimin e mekanizmit të brendshëm të sinjalizimit pranë Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, si dhe procedurën e administrimit dhe shqyrtimit të sinjalizimeve, në përputhje me Ligjin nr. 96/2025 “Për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

Neni 2 Qëllimi

Kjo rregullore përcakton rregullat dhe procedurat për administrimin dhe shqyrtimin e sinjalizimeve, si dhe për garantimin e masave organizative në përputhje me Ligjin nr. 96/2025.

Neni 3 Fusha e zbatimit

Çdo person që, në një kontekst pune pranë Gjykatës, përfshirë persona në marrëdhënie pune, aplikantë, persona që ofrojnë shërbime apo bashkëpunojnë profesionalisht me Gjykatën, sipas parashikimeve të Ligjit nr. 96/2025.

Neni 4 Kanalet e sinjalizimit

Sinjalizimi i brendshëm/i jashtëm mund të bëhet:

- a) me shkrim, nëpërmjet depozitimit fizik në regjistrin e posaçëm;
- b) nëpërmjet adresës elektronike të dedikuar;
- c) në mënyrë verbale, përmes takimit fizik ose linjës telefonike të dedikuar;
- ç) në mënyrë anonime.

Sinjalizimi verbal dokumentohet me procesverbal, i cili nënshkruhet nga sinjalizuesi, kur ky i fundit zgjedh të mos mbetet anonim.

Çdo sinjalizim regjistrohet në një regjistër të posaçëm, me akses të kufizuar, duke garantuar konfidencialitetin e identitetit të sinjalizuesit.

Sinjalizuesit i konfirmohet marrja e sinjalizimit brenda 7 ditëve nga regjistrimi, përveç rasteve kur ai ka kërkuar të mos njoftohet ose kur njoftimi rrezikon konfidencialitetin.

Neni 5

Njësia Përgjegjëse

1. Administrimi dhe trajtimi i sinjalizimeve kryhet nga Njësia Përgjegjëse, e caktuar me urdhër të Kryetarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.
2. Njësia Përgjegjëse përbëhet nga 2 anëtarë dhe ushtron funksionet e saj në mënyrë të pavarur dhe të paanshme.
3. Njësia Përgjegjëse ka këto detyra:
 - a) Merr, regjistron dhe administron sinjalizimet;
 - b) Siguron ruajtjen e konfidencialitetit të identitetit të sinjalizuesit dhe të informacionit të raportuar;
 - c) Kryen verifikimin paraprak dhe hetimin administrativ të sinjalizimeve, në përputhje me ligjin;
 - c) Ndjek afatet procedurale të parashikuara nga Ligji nr. 96/2025;
 - d) Dokumenton çdo veprim procedural me procesverbal;
 - e) Bashkëpunon me Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, sipas rastit.
 - f) Përgatit dhe paraqet pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI), jo më vonë se data 15 janar e vitit pasardhës, raportin vjetor të konsoliduar për sinjalizimet e marra dhe trajtimin e tyre, në përputhje me nenin 14, pika 12, të Ligjit nr. 96/2025.
4. Në rast konflikti interesi apo mungese të anëtarit, ai zëvendësohet sipas urdhrit të Kryetarit të Gjykatës.

Neni 6

Regjistri i sinjalizimit

1. Sinjalizimet regjistrohen në një regjistër të posaçëm protokolli ose elektronik për regjistrimin e sinjalizimeve.
2. Njësia përgjegjëse, nuk mund të refuzojë për asnjë shkak regjistrimin e sinjalizimit.

Neni 7

Shqyrtimi dhe hetimi administrativ i sinjalizimit

1. Njësia Përgjegjëse kryen verifikimin paraprak të sinjalizimit dhe, nëse konstaton elementë që kërkojnë hetim të mëtejshëm, zhvillon hetimin administrativ brenda afateve të përcaktuara nga Ligji nr. 96/2025.
2. Procedura e hetimit administrativ përfundon sa më shpejt që të jetë e mundur, por në çdo rast jo më vonë se 90 (nëntëdhjetë) ditë nga data e fillimit të saj, në përputhje me nenin 20 të Ligjit nr. 96/2025.
3. Gjatë hetimit administrativ, Njësia Përgjegjëse mund të kërkojë dokumente, informacione dhe sqarime nga strukturat përkatëse të Gjykatës, duke garantuar konfidencialitetin e sinjalizuesit.
4. Çdo veprim procedural dokumentohet dhe përfundimi i hetimit pasqyrohet në raport të arsyetuar.
5. Njësia Përgjegjëse ndjek me përgjegjshmëri ecurinë e sinjalizimit dhe informon sinjalizuesin për ecurinë dhe rezultatin përfundimtar jo më vonë se 3 (tre) muaj nga data e konfirmimit të

regjistrimit të sinjalizimit. Ky afat zbatohet edhe në rastet kur konfirmimi nuk është dërguar, në përputhje me nenin 15, shkronja b), të Ligjit nr. 96/2025.

Neni 8

Parimet e shqyrtimit

Shqyrtimi dhe hetimi administrativ i sinjalizimeve kryhet në përputhje me këto parime:

1. Ligjshmëria, duke respektuar dispozitat e Ligjit nr. 96/2025 dhe legjislacionin në fuqi.
2. Paanshmëria dhe objektiviteti, duke garantuar shqyrtim të pavarur nga çdo ndikim i jashtëm apo konflikt interesi.
3. Konfidencialiteti, duke mbrojtur identitetin e sinjalizuesit dhe çdo informacion që mund të çojë në identifikimin e tij.
4. Mbrojtja nga hakmarrja, duke ndaluar çdo veprim që mund të cenojë të drejtat e sinjalizuesit për shkak të sinjalizimit.
5. Mirëbesimi, duke vlerësuar sinjalizimin mbi bazën e bindjes së arsyeshme të sinjalizuesit për ekzistencën e një shkeljeje të mundshme.
6. Proporcionaliteti, duke garantuar që çdo veprim administrativ të jetë i arsyeshëm dhe i nevojshëm në raport me qëllimin e hetimit.
7. Prezumimi i pafajësisë, duke respektuar të drejtat e personit të përfshirë në sinjalizim deri në përfundim të shqyrtimit.

Neni 9

Mbrojtja e sinjalizuesit

1. Ndalohet çdo formë veprimi ose mosveprimi hakmarrës ndaj sinjalizuesit për shkak të sinjalizimit të bërë në përputhje me Ligjin nr. 96/2025.
2. Çdo akt hakmarrjeje është i pavlefshëm dhe nuk sjell pasoja juridike ndaj sinjalizuesit.
3. Çdo person që ndërmerr ose tenton të ndërmarrë veprime hakmarrëse mban përgjegjësi disiplinore dhe, sipas rastit, përgjegjësi ligjore.
4. Mbrojtja nga hakmarrja zbatohet sipas mekanizmit dhe procedurave të parashikuara në Ligjin nr. 96/2025.

Neni 10

Referimi tek autoritetet kompetente

1. Nëse gjatë shqyrtimit të sinjalizimit konstatohen elementë që bien në kompetencën e një autoriteti tjetër, Njësia Përgjegjëse referon çështjen pa vonesë pranë autoritetit përkatës, duke garantuar konfidencialitetin e identitetit të sinjalizuesit.
2. Në rast se sinjalizimi përmban elementë të përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarit, çështja i referohet Këshillit të Lartë Gjyqësor, në përputhje me legjislacionin për organizimin e pushtetit gjyqësor.
3. Në rast se sinjalizimi përmban indicie për kryerjen e një vepre penale, çështja i referohet organit kompetent të prokurorisë, sipas legjislacionit penal në fuqi.
4. Në rast se sinjalizuesi paraqet kërkesë për mbrojtje nga veprimet hakmarrëse ose kërkon sinjalizim të jashtëm, ai informohet për të drejtën për t'iu drejtuar Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI).

Neni 11
Përpunimi i të dhënave personale

1. Të dhënat personale të sinjalizuesit dhe të çdo personi tjetër të përfshirë në procesin e sinjalizimit përpunohen në përputhje me Ligjin nr. 96/2025 dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.
2. Përpunimi i të dhënave kryhet vetëm për qëllimet e administrimit dhe shqyrtimit të sinjalizimit dhe kufizohet në masën e nevojshme për realizimin e këtyre qëllimeve.
3. Aksesimi në të dhënat personale u lejohe vetëm anëtarëve të Njesisë Përgjegjëse dhe personave të autorizuar sipas ligjit.
4. Të dhënat personale ruhen për aq kohë sa është e nevojshme për përfundimin e procedurës dhe, në çdo rast, në përputhje me afatet e ruajtjes së dokumentacionit të parashikuara në këtë rregullore dhe në Ligjin nr. 96/2025.
5. Zbulimi i paautorizuar i të dhënave personale përbën shkelje disiplinore dhe sjell përgjegjësi sipas ligjit.

Neni 12
Ruajtja e dokumentacionit

Dokumentacioni i krijuar në kuadër të administrimit dhe hetimit administrativ të sinjalizimeve ruhet në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 96/2025 dhe legjislacionin për administrimin e dokumentacionit zyrtar.

Dokumentacioni origjinal ruhet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare nga data e komunikimit të rezultatit përfundimtar të procedurës së sinjalizimit, përveç rasteve kur procedura ligjore përkatëse është ende në proces dhe nuk ka përfunduar.

Neni 13
Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në datën e miratimit me urdhër të Kryetarit të Gjykatës së Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm.

